



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 556/1 prot.

Tiranë më 22. 5.2020

Lënda: Përgjigje kërkesës tuaj për mendim

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ka administruar kërkesën tuaj për mendim nr. 3127 prot., datë 19.05.2020, në lidhje me transferimin e mostrave biologjike për personat e ndaluar/arrestuar dhe ekzaminimin e tyre jashtë vendit.

Referuar informacionit të paraqitur në kërkesën tuaj, Zyra e Komisionerit vlerëson se transferimi i këtyre mostrave biologjike drejt Anglisë duhet kryer duke zbatuar detyrimet e përcaktuara në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim, “Ligji”).

Në këtë kuadër, në pikën 1 të nenit 8 të ligjit, parashikohet se transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale kryhet, me marrës, nga shtete me një nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale.

Në rastin tuaj, transferimi ndërkombëtar i të dhënave legjitimohet, pasi Anglia bën pjesë në listën e shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale, bazuar në Vendimin nr. 8, datë 31.10.2016 të Komisionerit “Për përcaktimin e shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”.

Megjithatë, ju bëjmë me dije se, në bazë të pikës 1 të nenit 27 të ligjit, është përgjegjësi e kontrolluesit ose përpunuesit të marrë masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi.

Për sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se kërkesa juaj nuk bie ndesh me parimet dhe kriteret e ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

